



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT-OPSHINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK



Zyra e Kryetarit të Komunës së Junikut
Vendimi nr. 01/100
10 Gusht 2022, Junik

1-180/6827
10/08 2022

Bazuar në nenin 58 paragrafin g) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale lidhur me nenin 42 paragrafin i) si dhe nenin 43 të Statutit të Komunës së Junikut nr. 001/3/27 të datës 30.09.2010, Kryetari i Komunës së Junikut merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2023-2025

I. Caktohet Grupi Punues për hartimin e Projekt-buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2023-2025, në këtë përbërje:

1. Arten Hamza- Zytari Kryesor Financiar, Kryesues
2. Florant Pepshi- Drejtorja Për Buxhet dhe Financa, Anëtar
3. Valbona Gaxherri- Drejtorja për Arsim Kultur Rini dhe Sport. Anëtare
4. Deme Ukaj- Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale, Anëtar
5. Avdyl Maloku- Drejtorja për Zhvillim Ekonomik
6. Ferdone Tofaj- Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis, Anëtare
7. Turim Ganiyaj- Drejtorja për Shërbime Publike dhe Inspeksion, Anëtar
8. Sundim Krasniqi- Drejtorja e Administratës së Përgjithshme
9. Rustem Pepshi- Zytar i IT-se, Anëtar

II. Grupi punues ka për detyrë që të hartojë Projekt-buxhetin e Komunës së Junikut për vitin 2023-2025, të bëjë hartimin e Planit të Brendshëm komunal për mbarëvajtjen e dëgjimeve buxhetore, të bëjë përgatitjen e njoftimit për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, të caktoj personin përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit gjatë mbajtjes së dëgjimeve publike dhe të bëjë hartimin e tij në afatin ligjor që parashihet në Udhëzimin Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimeve Publik, të bëjë hartimin e raportit nga dëgjimi buxhetorë dhe ta dërgoj në Kuvendin Komunal.

III. Obligohet Grupi Punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

IV. Grupi Punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

V. Obligohet Grupi punues që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

VI. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e grupit punues për hartimin e Projekt-buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2023-2025.

Vendimi i dërgohet:

1. Anëtarëve të Grupit Punues,
2. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
3. Arkivit.

